## A K T

## PER THEMELIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "KOSTURI" SHPK

Me vullnetin tim te lire une Astrit Kosturi, i biri i Hetemit, i ditlindjes 22 Dhjetor 1958, lindur ne Lenie te rrethit te Gramshit dhe banues ne qytetin e Gramshit, lagjia "Sporti", pallati 162, me arsim te larte Bio-Kimi, vendosja te krijoj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertim "Kosturi" SHPK konforme ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

### NENI 1:

Shoqeria "Kosturi", SHPK eshte person juridik. Kete te drejte ajo e fiton me regjistrimin e saj ne Gjykate dhe ne regjistrin tregeta si dhe organin tatimor. Shoqera vepron ne baze te ligjit, ketij akti-themelimi dhe statutit bashkangjitur.

Shoqeria perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin themelor.

### NENI 2:

Shoqeria ka selin e saj ne qytetin e Gramshit, lagjia "Sporti", pallati 162 .Ajo mund te hape dege filjale e perfaqesi ne tere teritorin e Republikes se Shqiperise.

### NENI 3:

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj:

- Import-eksportin e mallrave, lendeve te para, materialeve te ndryshme, makinerive, paisjeve etj.

- Prodhimin dhe shitjen e artikujve ushqimor, si pije alkolike te ndryshme, pije freskuese e produkte te tjera ushqimore etj.

Shoqeria mund te kryeje gjithashtu çdo lloj operacioni tjeter tregetar e financiare per pasuri te luajtshme e te paluajtshme, por te nevojshme per realizimin e qëllimeve te shoqerise. Ajo mund te marre pjese dhe bashkepunoj me shoqeri dhe ndermarrje te tjera, qe kane

./.

aktivitet apo te ngjashem me te sajin.

NENI 4:

Kapitali themelor i shoqerise eshte 2.5 milion leke.Kapital i mesiperm u mor persiper dhe u nenshkrua nga une ortaku i vetem. Ai perbehet nga 10 kuota, ku çdo kuote ka vleren 250mije leke,

NENI 5:

Fitimet e realizuara nga shoqeria pas shlyerjes se detyrimeve ligjore do te mbeten ne favor te ortakut te vetem Z.Astrit Kosturi, i cili ka te drejte ta perdor ate ne menyre te pavarur dhe ne interes te tij.

NENI 6:

Shoqeria pasi paguan taksat,tatimet dhe detyrimet ligjore ne pergjithesi ka te drejte te krijoje fondin rezerve dhe fonde te veçanta financimi.

NENI 7:

Shoqeria per te ardhurat dhe shpenzimet do te nxjerre rezultatet e saj me bilanc, duke ju pergjigjur korrektesisht detyrimeve ligjore.

NENI 8:

Shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes e specialiste me kontrate pune, duke respektuar legjislacionin per marredheniet e punes.

NENI 9:

Shoqeria mund te emeroje ekspert-kontabel te autorizuar, duke ju permbajtur kritereve te percaktuara ne ligjin nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

Te drejten e emerimit te tyre e ka ortaku i vetem.

./.

NENI 10:

Administrator i shoqerise eshte Z.Astrit Kosturi, i cili kryen administrimin e zakonshem dhe te jashtzakonshem te saj.Sipas ligjit administrator mund te caktohet prej tij edhe nje person tjeter jo ortak.

NENI 11:

Me miratim te ortakut tevetem numri i ortakeve mund te shtohet. Ortaku i ri duhet te investoj kapital te barabarte ose sipas marreveshjes edhe me persona te tjere, kur eshte dakord ortaku i vetem i shoqerise.

NENI 12 :

Shoqeria mund te pushoje se funksionuari ose te shenderrohet ne nje shoqeri tjeter sipas rregullave te percaktuara ne ligjin "Per shoqerit tregetare".

Kontrata u perpilua ne kater kopje dhe firmoset rregullisht nga une ortaku i vetem Astrit Kosturi

Tirane,me dt. 31.1.1994

ORTAKU I VETEM
( Astrit Kosturi)

# S T A T U T

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " KOSTURI "SHPK.

### NENI 1:

Eshte themeluar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "KOSTURI" SHPK.Shoqeria perbehet nga nje ortak i vetem Z. Astrit Kosturi,i datelindjes 22 Dhjetor 1958, banues ne lagjen "Sporti", palleti 162 Gramsh.

### NENI 2:

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj:

- Import - eksportin e mallrave, lendeve te para,materialeve te ndryshme, makinerive, paisjeve etj.

- Prodhimin dhe shitjen e artikujve ushqimor, si pije alkolik te ndryshme, pije freskuese e produkte te tjera te kesaj natyre.

Shoqeria mund te kryeje gjithashtu çdo lloj operacioni tjeter, tregetar e financiare per pasuri te luajtshme e te paluajtsh por te nevojshme per realizimin e qellimeve te shoqerise. Ajo mund te merre pjese dhe bashkepunoi me shoqeri dhe ndermarrje te tjera, qe kam aktivitet te njejte apo te ngjashem me te sajin.

### NENI 3:

Shoqeria " KOSTURI "SHPK fiton zotesine per teveprua pas regjistrimit te saj ne gjykate dhe ne regjistrin tregetar prano Gjykates se Rrethit Tirane si dhe ne organet tatimore. Ajo zhvillon veprimtarine e saj ne baze te ligjeve qe normojne dhe rregullojne kete veprimtari dhe statutit te saj.

### NENI 4:

Shoqeria e ka selin e saj ne qytetin e Gramshit, lagjie "Sporti", pallati 162. Ajo mund te hape dege, filjale e perfaqesi ne tere teritorin e Republikes se Shqiperise.

./.

NENI 5:

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte percaktuar 11 vjet. Me vendim te ortakut te vetem, shoqeria mund te zgjase kete afat, por edhe mund te zvogeloje nen kete afat, per çfardolloj shkaku dhe arsyeje te gjykohet e vendoset nga ortaku i vetem.

NENI 6:

Kapitali themelor i shoqerise eshte caktuar 2.5 milion leke (dy presje pese milion leke) i ndare ne kuota nga 250 mije leke per çdo kuote. I tere kapitali zoterohet nga ortaku i vetem Z.Astrit Kosturi.

Kapitali themelor eshte lirisht i transferueshem ne rruge trashegimenie.

NENI 7:

Ortaku i vetem Z.Astrit Kosturi ushtron kompetencat qe i jane caktuar asamblese se ortakeve sipas ligjit 7638, date 19.1.1992 "Per shoqerite tregetare".

NENI 8:

Kapitali tregetar nuk mund te perfaqesohet nga letra me vlere te trashegueshme. Kapitali themelor ose pjesa e tij mund te transferohen ose shiten personave te trete vetem me miratim te ortakut te vetem Z.Astrit Kosturi.

Ortaku ka te drejte te marre vendime per ndryshimin e statutit. Vendimet e tij te marra ne vend te asamblese evidencohen ne nje regjister.

NENI 9:

Shoqeria administrohet nga nje administrator ne rastin konkret administrator do te jete ortaku i vetem Z.Astrit Kosturi, i cili qendron ne drejtim deri ne fund te afatit te shoqerise. Ai ka te drejte me kompetence per administrimin e zakonshem dhe te jashtzakonshem te shoqerise.

./.

NENI 10 :

Ne rast se ne te ardhmen do te caktohet nje administrator jo ortak ai do te kete te gjitha kompetencat ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligja ja jep shprehimisht ortakut.

Te gjitha te drejtat dhe detyrat e administratorit ne rast se ai caktohet me nje akt te mevonshem, do te jene ato te percaktuara ne nenin 16 e vijuar te ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

NENI 11:

Shoqeria ka te drejte te hyje ne marredhenie me Bankat Shqiptare dhe te huaja, te çele llogarite perkatese, te kerkoje po te kete nevoje kredi prej tyre, te marre hua e te kryje operacionet e nevojshme bankare per llogari te saj.

NENI 12:

Shoqeria ka te drejte te punesoje punetore e specialiste duke respektuar dispozitat ligjore " Per marredheniet e punes".

NENI 13:

Shoqeria eshte pronare e perdoruese e pasurise se saj.Ajo ka te drejte te krijoje fondin rezerve dhe fonde te tjera te veçanta financimi per zhvillimin dhe aritjet e saj.

NENI 14:

Veprimet ekonomiko-financiare mbyllen me date 31 Dhjetor te çdo viti. Administratori dhe specialistet e ngarkuar prej tij nxjerrin bilancin me te ardhurat dhe shpenzimet,per te llogaritur fitimin, i cili kalon ne favor te ortakut te vetem.

NENI 15:

Aktiviteti i shoqerise nderpritet me mbarimin e afatit te sc ne qofte se nuk shtyhet afati i percaktuar ne kete statut si dhe ne rast fali,entimi.Por shoqeria mund te shperbehet per çfardolloj

./.

shkaku tjeter dhe ne çdo kohe, ne keto raste ortaku i vetem rregullon menyrat e likujdimit dhe emeron nje ose me shume likujdatore, duke u percaktuar atyre edhe fuqite qe kane.

NENI 16:

Per rregullat e tjera qe nuk jane parashikuar ne kete statut vlejne dispozitat e ligjit 7638,date 19.11.1992 "Per shoqerite me pergjegjesi te kufizuar" si dhe aktet e tjera ligjore qe rregullojne kete veprimtari

Statuti u redaktua ne kater kopje te barabarta.

Tirane,sot me dt.31.1.1994

ORTAKU I VETEM

( Astrit Kosturi)